

28. 08. 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *Ndërtim Rrugët "Teuta"+ Rr."Kacaniku"+ Rr."Kelmendi"+Seg.Kacaniku"+Rr."Legjendare"+ Rr."Delvine"+Rr."Jezerca"*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):) 45233120-6

Punime ndërtimi në rrugë

Afati i realizimit të punimeve është **95 ditë pune**, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Vlera e fondit limit: *66,704,734.90(gjashtëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.*

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 7 të DST.

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarinimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022,2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare (2021, 2022, 2023)**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika”c”, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve, *kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë

05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se **50%** e vlerës se përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Dhe /ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e puneve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpallje së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,

- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore.
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimtar të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 39 pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve te sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar**

përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjelle kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikojnë legjislacionin e prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

2.3.3. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P - 1 A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P - 4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- N.P - 7 A Ujshjellësa , gazshjellësa , vajshjellësa , vepra kullimi e vaditje;
- NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S – 18 A Punime topogjodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategorite e licenses “N.P dhe N.S” te përcaktuara ne piken 2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik jane hartuar ne përputhje me zërat konkret të punës që përmban preventivi i punimeve. Me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për këto kategori si dhe të disponojë nënkategoritë sipas gjurmave që parashikohen nga legjislacioni përkatës. Përcaktimi i nënkategorive është vendosur nga mbledhja e vlerave të secilit volum pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.P-1A (Punime gjurmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjurmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 4 C (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime *Punime ne rruge*, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 7 A Ujshjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje ;

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime *Punime seksioni II Punime ne KUB,KUN* ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne punime prishje punime me blloqe , te cilat shtojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorine N.S-1A.

N.S - 6 A Sinjalistika rrugore jodriçuese

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne sinjalistiken rrugore jo ndricuese , te cilat shtojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorine N.S-6A.

N.S-18 A (Punime topogjeodezike)

Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar minimumi **45(dyzete e pese)** punonjes (bashke me stafin Teknik)te vertetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi per **3 (tre) muajt e fundit** te deklaruar nga data e hapjes se ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjese, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, minimumi prej gjithsej 45(dyzete e pese) punonjes (bashke me stafin Teknik), është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Konkretisht:

Konkretisht:

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Afati 88 ditë

Sasia e orëve të punës sipas manualit është $31,680 : 8 : 88 = 45$ punonjës

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeoinformatik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar për inxhinieret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

- Duke analizuar preventivin e punimeve, si dhe referuar objektit të prokurimit disponueshmëria nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të një inxhinier ndërtimi me profil infrastrukturë transporti, si dhe mendimi i tij i specializuar ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, të kryejë një rrugë me standarte dhe punime sipas kushteve teknike, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor. si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-1, NP-4, NS-1, NS - 6** është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. profili Infrastuktur Transporti

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për një inxhinier ndërtimi me profil infrastrukturë transporti, është një kërkesë në përputhje me preventivin e punimeve dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- Lidhur me disponueshmërinë e **Inxhinierit Hidroteknik**, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një inxhinier Hidroteknik, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, porë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e punimeve, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP-7** është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**
- **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**, kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rievitimin e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses. si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS 18** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij inxhinieri.
- Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Gjeoinformatik** i cili është përgjegjës për leximin dhe interpretimin e hartave dhe projekteve të objektit
- *(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin*

mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.6.Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas perqindjes se bashkepunitit).

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë liçencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të

shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dëpsozitive ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve në objektin e kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar me arsim të lart dhe të mesëm si staf mbështetës. Specialistet të shoqërohen me kontrata pune, diplome/ certifikate, Certifikate e vlefshme të sigurimit teknik.

2 (dy) Teknik Ndërtimi
1 (një) Teknik Topograf/Gjeodet

- a) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për specialistet, emër/mbiemër, profilin e punës, datën e kontratës individuale të punës, numrin e certifikatës profesionale si dhe institucionin private ose shtetërorë që e ka leshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin si staf mbështetës është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

- 2 (dy) Teknik Ndërtimi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses;
- 1 (një) Teknik Topograf/Gjeodet prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses;

Kërkesa specifike për stafin mbështetës është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili i stafit mbështetës.) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Në preventivin e Punimeve ka zëra pune si: Gërmim dheu, Gërmim dheu për shtyllat dhe pusetat + transp... ; si dhe zëra të tjerë të cilët shtrajnë domosdoshmërinë dhe nevojën për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

2.3.8. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes të specializuar/kualifikuar si me poshte:

2 (dy) Hidraulikë
1 (një) Elektracist
3 (tre) Karpentierë
2 (dy) Hekurkthyes
2 (dy) Betonues

- 2 (dy) Specialistë vendosje bordurash
- 2 (dy) Specialistë shtrim beton trotuari
- 4 (katër) Punëtorë asfalti
- 10 (dhjetë) Punëtorë krahu
- 3 (tre) Manovratorë/Ekskavatoristë
- 3 (tre) Shoferë
- 2 (dy) Automakinistë
- 1 (një) Buldozerist

Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Për punonjesit manovrator/shofer/,Ekskavatorist ofertuesi duhet të paraqesë:

- b) kontratë individuale të punës;
- c) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere/Ekskavatorist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- d) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per specialistet , emer/mbiemer, profil i punes, daten e kontratës individuale të punës, numrin e certifikates profesionale si dhe institucioni private ose shtetore qe e ka leshuar.
- e) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste, automakinist , buldozerist dhe shofer , emer/mbiemer, profil i punes, daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- f) Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

Në rastin kur punonjësit Manovratorë/Ekskavatoristë ose shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe

do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik.

Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

Në lidhje me

- **2 (dy) punonjes hidraulik** nevojitet për kryerjen e punimeve hidraulike dhe punimet në KUN, duke marrë parasysh punimet hidraulike përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 1420:8:88=2.02 punonjës
- **1 (një) punonjes elektrikist** nevojitet për kryerjen e punimeve elektrike duke marrë parasysh punimet elektrike përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 666:8:88=0.95 punonjës
- **3 (tre) punonjes karpentierë** nevojiten për kryerjen e punimeve karpenterie duke marrë parasysh punimet armature përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 3063:8:88=4.35 punonjës
- **2 (dy) punonjes hekurkthyes** nevojiten për kryerjen e punimeve të hekurit duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 3048:8:88=4.33 punonjës
- **2 (dy) punonjes betonues** nevojiten për kryerjen e punimeve të betonit duke marrë parasysh punimet betoni përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 3064:8:88=4.35 punonjës
- **2 (dy) punonjes specialistë për vendosje bordurash** nevojiten për kryerjen e punimeve të vendosjes së bordurave duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 1896:8:88=2.7 punonjës
- **2 (dy) punonjes pllakashtrues (specialistë shtrim pllaka trotuari)** nevojiten për kryerjen e punimeve të shtrimit të pllakave të trotuarit duke marrë parasysh punimet përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 4200:8:88=5.95 punonjës
- **4 (kater) punëtorë asfalti** nevojiten për kryerjen e punimeve asfaltike duke marrë parasysh punimet e asfaltimit përkatëse në zërat e preventivit.
Sasia e orëve të punës sipas manualit është: 2553:8:88=3.63 punonjës
- **10 (dhjete) punëtorë krahu** nevojiten për kryerjen e punimeve të ndryshme në të gjithë zërat e preventivit.

- **3 (tre) Manovratorë/Ekskavatoristë nevojiten per drejtimin e** eskavator me goma dhe me zinxhirë, minieskavator, fadromat, minifadromat te kerkuara ne listen e mjeteve
- **3 (tre) Automakinist nevojiten per drejtimin e** autovinc, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe te kerkuara ne listen e mjeteve
- **1(nje) Buldozerist nevojitet per drejtimin** buldozerë, greidera (nivelues), rrul vibrues, shtruese asfalto-betoni te kerkuara ne listen e mjeteve
- **3 (tre) Shofer nevojitet per drejtimin e** kamionave dhe kamioncinave

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e *Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 11. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.10 Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve te ngurta, inerte". Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht te perfshihen kodet 20 03 04, 20 03 06, 17 05 04 dhe 17 09 04.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: "leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet perkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji". Në shtojcën 1/B eshte listuar edhe veprimtaria "Menaxhimi i mbetjeve". Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, parashikohet se: "Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", pas miratimit të saj nga ministri". Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta": "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme".

2.3.11 Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratorit të ketë të akredituara këto teste SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1008:2006, SSH EN 1744- 1:2009+A1:2012, SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.311 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma*

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.12 .Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ne pune **ISO 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 12 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2. **ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
3. **ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi

i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

4. **ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.13 Operatori Ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet emeposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	4 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
3	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-13 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Kamionçina me kapacitet 1-5 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Kamion me vinc me kapacitet ngrites 3.5 t me gjatesi krahu min 10 m	1 copë	Në pronësi ose me qira
7	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	2 copë	Në pronësi ose me qira
8	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qira
9	Rrul për bankinat 1 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Fadrome me goma me targa	1 copë	Në pronësi ose me qira
11	Eskavator me zinxhir + çekiç	1 copë	Në pronësi ose me qira
12	Eskavator me goma me targa	2 copë	Në pronësi ose me qira
13	Minieskavator me zinxhirë gome	1 copë	Në pronësi ose me qira
14	Grejder me goma me targa	1 copë	Në pronësi ose me qira
15	Asfaltoshtuese	1 copë	Në pronësi ose me qira
16	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qira
17	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qira
18	Autobetonierë	2 copë	Në pronësi ose me qira
19	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
20	Buldozer	1 copë	Në pronësi ose me qira
21	Makineri për vijezim rruge me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qira

22	Betonierë kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qira
23	Depozitë uji 5000 litra	1 copë	Në pronësi ose me qira
24	Betoforma	300 m ²	Në pronësi ose me qira
25	Nivelues/Helicopter betoni	2 copë	Në pronësi ose me qira
26	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qira
27	Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qira
28	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qira
29	Gjenerator ≥ 3.5 kw	1 copë	Në pronësi ose me qira
30	Frezë për skarifikim asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qira
31	Kontenjer (zyre)	1 copë	Në pronësi ose me qira
32	Impiant prodhim betoni me QKL	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
33	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
Mjete mbrojtëse			
	Kokore	45 copë	Në pronësi ose me qira
	Jelek	45 copë	Në pronësi ose me qira
	Fikse Zjarri	3 copë	Në pronësi ose me qira
	Tabela Sigurimi Teknik	18 copë	Në pronësi ose me qira
	Tabela rrugore (devijim, punime etj)	4 copë	Në pronësi ose me qira
	Kuti Ndihmë e shpejtë	3 copë	Në pronësi ose me qira
	Prozhektorë për ndriçim	2 copë	Në pronësi ose me qira

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);

b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);

d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;

e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

f) çertifikatë transporti. Në rastin e autobitumatrices duhet të paraqitet çertifikata e transportit për lende të rezikshme.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

a) kontrata e qerasë;

- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.
- f) çertifikatë transporti. Në rastin e autobitumatrices duhet të paraqitet çertifikata e transportit për lende të rezikshme.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra vërteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

1. **Eskavatorë, fadroma, buldozer, minieskavator, minifadromë, dumper dhe kamionët vetëshkarkues janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume të preventivit**

2. *Kamionçina, minieskavator, tokmaku ngjeshës dhe pajisjet e tjera ndihmëse janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume e preventivit*
3. *Autobetonierë, pompë betoni, betonierë, vibrator betoni dhe autobot uji janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume e preventivit si mure massive betoni beton bordure dhe kunete;*
4. *Betoformat 350m² janë kërkuar në përputhje me zërat dhe volume e preventivit për ndërtimin e armaturës për muret e betonit dhe dhe punimet e tjera karpenterije ;*

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- *Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.*
- *Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.do t’i kërkojë ofertuesit i klasifikuar i pari, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit per disponimin e punonjesve, mjeteve/pajisjeve do te jete kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

Njesia e prokurimit